



**REPUBLIKA E KOSOVË**



**KOMUNA VUSHTRRI**

---

**KORNIZA AFATMESME BUXHETORE  
2017 - 2019**

**KOMUNA E VUSHTRRISË**

# Përmbajtja

I. Hyrje

II. Strategjia Zhvillimore Komunale - Deklarata e Prioriteteve Afatmesme

III. Korniza Fiskale

3.1 Korniza makroekonomike komunale

3.2 Tendenca e të hyrave komunale dhe parashikimet 2017-2019

3.3 Plani Komunal i Bashkëfinancimit Sektorial me Ministritë e Linjes dhe Financimi i Jashtëm

3.4 Politikat e reja

3.5 Shpenzimet komunale dhe parashikimet 2017-2019

3.6. Analiza Gjinore

IV. Korniza e Përformancës së Shpenzimeve

V. Informacionet sipas programeve


## I. Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore, KAB, që po prezantohet është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Gjithashtu, KAB, siguron mekanizmat e nevojshëm për arritjen objektivat prioritare, të identifikuar në dokumentet strategjike të Komunës, përmes integritit sa më të mirë në procesin buxhetor.

**Kuadri Ligjor:** Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkorja Buxhetore 2017/01 të lëshuara nga Ministria e Financave në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritare të zhvillimit dhe identifikimin e prioritetëve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2017-2019.

Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB Komunale dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:



## II. Deklarata e Prioriteteve Afatmesme 2017-2019 nga Strategjia Zhillimore Komunale

Komuna e Vushtrrisë shtrihet në pjesën veriperëndimore të Rrafshit të Kosovës, në zonën ku afrohen bjeshkët e Shalës dhe Çyqavicës, bri lunit Silnica. Vushtrria është qytet historik i njohur që nga koha bizantine ilire-romake dhe me emërtime të ndryshme. Vushtrria është qendër komunale në të cilin gravitojnë 67 lokalitete të banuara. Territori i komunës përfshin një sipërfaqe prej 345 km<sup>2</sup>. Pozita gjeografike që ka i mundëson asaj lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit. Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, Komuna e Vushtrrisë ka 69 870 banorë të organizuar në 11 866 ekonomi familjare .

Bazuar në të dhënat e Zyrës për Regjistrim të Bizneseve në Komunë në komunën e Vushtrrisë operojnë rreth 2,470 biznese, pjesë e konsiderueshme e tyre merren me veprimtari tregtare 37.37% , në sektorin e shërbimeve (hotele dhe restorante) 10 % , industri përpunuese 8.66 etj. Duhet të ceket se nga ky numër aktive janë 1 604 biznese

Struktura e veprimtarive ekonomike

	Veprimtarit ekonomike	Numri i bizneseve	Përqindja
1	Bujqësia, Gjuetia dhe pylltaria	149	6.03
2	Peshkimi	2	0.08
3	Industria nxjerrëse	6	0.24
4	Industria përpunuese	214	8.66
5	Prodhimi me energji elektrike, gaz, ujë, avull, ujë të ngrohtë	4	0.16
6	Ndërtimtaria	171	6.92
7	Treg.me shumice dhe pakice, rip. i auto dhe aparateve tjera të amvisëri	923	37.37
8	Hotelet dhe Restorantet	247	10.00
9	Transporti, depot dhe telekomunikacion	416	16.84
10	Aktivitete financiare	4	0.16
11	Afarizmi me pasurit e patundshme	100	4.05
13	Arsimi	28	1.13
14	Shëndetësia	46	1.86
15	Aktivitet tjera shoqërore dhe personale	160	6.48
	<b>Totali</b>	<b>2,470</b>	<b>100.00</b>

Vizioni i mëposhtëm për Komunën e Vushtrrisë i definuar pas konsultimeve me akterët e rëndësishëm të jetës politike ekonomike e sociale në Komunë bazohet edhe në dokumentet afatmesme dhe afatgjata strategjike, që ka zhvilluar Komuna siç janë: Strategjia e Zhvillimit Ekonomik e Komunës 2013-2018 , Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2017-2019 të Qeverisë së Kosovës dhe prioriteteve bazë të saj, si dhe Qarkoren Buxhetore Komunale 2017/01) të lëshuar nga ministria e Financave të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

**Për tri vitet e ardhshme, vizioni i Komunës së e Vushtrrisë është të jetë qendër e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, me urbanizëm modern dhe shërbime efikase e kualitative, i integruar në proceset rajonale dhe ndërkombëtare, si një qendër e kulturës së pasur, arsimimit dhe jetës sportive dhe synon një kualitet më të mirë të jetesës për qytetarët e saj.**

Atributet më të rëndësishme të çfarëdo dokumenti të planifikimit strategjik dhe vizionit të definuar janë së pari lehtësia e komunikimit si dhe së dyti llogaridhënia.

Me qëllim të përmbushjes së këtyre dy attributeve prioritet strategjike të Komunës në periudhën afatmesme janë grupuar në katër prioritete që do të mundësojnë realizimin e qëllimit të vizionit tonë për Komunën.

## **I. Forcimi i Ekonomisë Komunale me mundësi për të gjithë**

Rritja e ekonomisë komunale përmes:

- Përmirësimit të standardeve të arsimimit dhe edukimit cilësor;
- Mbështetjes direkte të sektorit bujqësor dhe blegtorisë
- Mbështetjes direkte të sektorit bujqësor, pylltarisë e blegtorisë;
- Krijimit të një ambienti të favorshëm ndërmarrës;
- Mbështetjes së industrisë përpunuese;
- Promovimit të strategjisë së investimeve të huaja të diasporës dhe investimeve lokale;

## **2. Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve**

Krijimi dhe ndihma për qytetarët për të pasur jetë të shëndetshme dhe aktive në komunitetin e tyre:

- Asistenca sociale për familjet në nevojë, pa të ardhura/të ardhura të ulëta
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shëndetësisë mobile

## **3. Përmirësimi i ambientit të Komunës dhe qëndrueshmëria e tij**

- Përmirësimit dhe rigjenerimit të infrastrukturës rrugore (sinjalizimi horizontal e vertikal, ndriqimi publik dhe numerizimi); transportit; dhe kanalizimit

- Përmirësimin të standardeve të ambientale
- Ofrimi i më shumë hapësirave të gjelbëruara

Ndërsa prioriteti i fundit strategjik i Komunës ka të bëjë me efikasitetin e brendshëm të qeverisë komunale dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët e saj.

#### **4. Krijimi i qeverisë komunale që ofron shërbime efikase dhe që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve**

Përmirësimi i shërbimeve komunale karshi qytetarëve duke u fokusuar qasjen më të afërt dhe të lehtë të tyre në administratë përmes:

Katër fushat prioritare të komunës dhe objektivat e saj për periudhën afatmesme 2017-2019 do të shoqërohen me shuma të hyrash dhe shpenzimesh në të pesë kategoritë ekonomike të cilat do të mund të monitorohen dhe raportohen karshi arritjeve.

### III. Korniza Fiskale Komunale

3.1 Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtëpërdrejt politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore), mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyren fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën më poshtë. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit Korniza Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2017-2019 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Komponentet e politikës makroekonomike sic janë Bruto Produkti Vendor, inflacioni dhe demografia duhet konsideruar dhe marrë parasysh. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2017-2019 e Qeverisë së Kosovës bazuar në të dhënat historike si dhe në zhvillimet e fundit ekonomike, nënvizon faktin se do të ketë ecuri pozitive të rritjes ekonomike në vitet e ardhshme, më saktësisht në periudhën 2017 - 2019 parashihet një rritje reale vjetore mesatarisht 4 % .

Komuna nga ana e saj do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe rritjes së të ardhurave të tyre, rrejdhimisht rritjes së të hyrave buxhetore komunale.

Aktualisht financimi komunal përfshinë: **1. Të Hyrat Vetanake dhe 2. Grantet Qeveritare.** Komunitat po ashtu janë pranuese të **granteve të donatorëve** (me mbulim të plotë apo si pjesë të bashkëfinancimeve), si dhe kanë mundësinë e huamarrjes sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Komuna e Vushtrrisë në periudhën afatmesme buxhetore 2017-2019 nuk planifikon të marrë hua nga institucione financiare për të financuar projektet e saj, sic e ka lejuar Ligji për Financat Publike.


Tabela I: Indikatorët ekonomik komunal

Përshkrimi	2016	2017	2018	2019 (vlerësim)
<b>Indikatorët makroekonomik në Kosovë</b>				
Rritja reale e BPV në %	3.8	3.9	4.0	4.0
Inflacioni në %	0.2	0.9	1.3	1.6
BPV për kokë banori, në euro	3,332	3,488	3,668	3,876
<b>Indikatorët ekonomik komunal</b>				
Popullsia e Komunës	72,762	73,184	73,586	73,969
Numri i bizneseve të regjistruara	2,412	2,470	2,481	2,496
Numri i nxënësve	14,934	14,900	14,800	14,700

### 3.2 Të Hyrat Komunale dhe Parashikimi Afat-mesëm 2016-2018

Të hyrat e Komunës së Vushtrrisë nga dy burimet e saj kryesore – grantet qeveritare si dhe të hyrat vetanake komunale kanë shënuar rritje nga viti në vit në përjashtim të vitit 2016 ku kemi pasur një stagnim.

Figura I: Buxheti Total i Komunës në vite , milion Euro:



Në bazë të planifikimit të bërë nga viti 2014, grantet qeveritare për Komunën e Vushtrrisë, si tërësi do të shënojnë rritje graduale. Rritja e granteve qeveritare do të jetë përafërsisht 8 % në krahasim me vitin 2016. Sipas të dhënave të prezantuara në tabelën më poshtë, kjo rritje kryesisht bazohet në të dhënat e përgjithshme për rritjen buxhetore që planifikohet në nivel të Qeverisë nacionale, siç parashihet me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2017-2019. Rritja kryesisht është reflektuar në Grantin e Përgjithshëm të Komunës si dhe në masë të madhe nga ngritja e planifikimit për të Hyrat Vetanake (shih më poshtë tabelën 2)

	2014	2015	2016	2017
<b>Grantet Qeveritare</b>	<b>11,767,233.00</b>	<b>12,950,092.00</b>	<b>13,018,417.00</b>	<b>14,172,353 .00</b>
<b>Të Hyrat Vetanake</b>	<b>1,652,000.00</b>	<b>1,675,327.00</b>	<b>1,703,418.00</b>	<b>1,730,000.00</b>
<b>TOTALI</b>	<b>13,419,233.00</b>	<b>14,625,419.00</b>	<b>14,721,835.00</b>	<b>15,902,353.00</b>

Të hyrat vetanake komunale, në anën tjetër, kanë shënuar rritje të ndjeshme nga viti në vit po ashtu, mirpo ngritja e të hyrave vetanake komunale sipas formulës ka ndikuar në rritjen e planifikimit për të hyra vetanake e cila nuk është në përputhje me trendin real e ngritjes së të hyrave vetanake . Projektioni i të hyrave vetanake me Qarkoren Buxhetore 2017/01 është 2,316,735 ose shprehur në përqindje 36% më i lartë krahasuar me vitin 2016. Kjo rritje kryesisht është koncentruar në të hyra si nga tatimi në pronë dhe lejet e ndërtimit ku norma tatimore për vitet 2017-2019 nuk ka rritje në bazë të legjislacionit në fuqi, duke llogaritur gjithcka tjetër njëjtë, prandaj Kryetari i Komunës i ka shkruar një kërkesë Ministrin të Financave që të korigjohet kjo rritje enorme e projektionit të të hyrave vetanake. Gjatë hartimit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve Komunale ne jemi bazuar në planifikimin që për mendimin tonë është në përputhje me trendin e realizimit të të hyrave vetanake. Shuma që planifikon komuna ta inkasoj është



1,730,000 €. Me Qarkoren Buxhetore 2017/01 në Tabelën nr.2 është paraparë Kontigjenca për korrektimin e formulës në shumë 4 milion euro, i cili korrektim do të mbështetet në plotësim-ndryshimin e Ligjit të financave të pushtetit lokal ose vendim të qeverisë.

### Kalkulimet e Tatimit në Pronë:

- *Vlera e Patundshmërisë* – sipas ndarjes së pronave në kategori zonave
- *Vlera e Kalkuluar Vjetore* - që duhet të mblidhet sipas vlerësimit të pronës (nëse supozojmë 100% pagesë sipas normave të përcaktuara me ligj)
- *Norma e Pagesës Vjetore* - Pagesat për vit, duke përjashtuar pagesat e borxhit, interesin dhe penaltitë, si përqindje e vlerës vjetore të kalkuluar
- *Borxhi i Akumuluar dhe Pagesa e Pritur e Borxhit*
- *Ndryshimet e pritura në normën e pagesës vjetore*

### Kalkulimet e të hyrave tjera:

- Të gjitha të hyrat tjera vetanake të Komunave janë të hyra jo-tatimore (kryesisht taksa dhe pagesa tjera)
- Niveli i taksave dhe pagesave tjera vendoset nën principin e mbulueshmërisë së shpenzimeve të dedikuara për ofrimin e shërbimit komunal.
- Parashikimi i këtyre të hyrave duhet të bëhet duke parashikuar volumin e shërbimeve të ofruara

Tabela 2: Planifikimi i të hyrave vetanake komunale sipas burimit për periudhën 2017-2019, në Euro

Komuna: Vushtrri	Grante dhe të hyra vetanake (HV) – 2016	Grante dhe të hyra vetanake – 2017	Grante dhe të hyra vetanake – 2018	Grante dhe të hyra vetanake - 2019
	në Euro	në Euro	në Euro	në Euro
<b>Burimet e të hyrave</b>				
Granti i përgjithshëm	5,075,275	6,069,037	5,682,184	5,964,153
Granti për arsim	6,291,206	6,372,875	6,372,875	6,372,875
Granti për shëndetësi	1,651,936	1,730,441	1,730,441	1,730,441
<b>Gjithsej Grantet</b>	<b>13,018,417.00</b>	<b>14,172,353.00</b>	<b>13,785,500.35</b>	<b>14,067,469.35</b>
<b>Të bartura</b>	<b>459,100.00</b>			
<b>Viti aktual</b>	<b>1,703,418</b>	<b>1,730,000</b>	<b>2,316,735</b>	<b>2,316,735</b>
<b>Gjithsej të hyrat vetanake</b>	<b>2,162,518.00</b>	<b>1,730,000.00</b>	<b>2,316,735.00</b>	<b>2,316,735.00</b>
<b>GJITHSEJ TË HYRAT KOMUNALE</b>	<b>15,180,935.00</b>	<b>15,902,353.00</b>	<b>16,102,235.35</b>	<b>16,384,204.35</b>

Komuna e Vushtrrisë vazhdon të dominohet në buxhetin total të saj nga transferet qeveritare të cilat edhe në tri vitet e ardhshme do të përbëjnë afërsisht 80% të buxhetit total të komunës.

## **Të hyrat vetanake**

Financimi komunal nga të hyrat vetanake komunale për vitin 2017, të parashikuar në KASH Komunal 2017-2019, bazohet në dispozitat e ligjit për Financat e Pushtetit Lokal

Të gjitha të hyrat nga burimet në vijim janë të hyra vetanake të komunës: tatimi në pronë, taksat komunale, gjobat, tarifat dhe pagesat në pajtim me autoritetin që u është dhënë komunave me LFPL.

Të gjitha të hyrat e mbledhura ose të pranuar nga komuna në bazë të autorizimit të një ligji nga burimet

në vijim, janë të hyra vetanake të komunës:

a) taksat komunale, gjobat, tarifat e shfrytëzimit, pagesat e tjera për shërbimet publike të ofruara nga komuna si dhe detyrimet rregullatore dhe gjobat e autorizuar në bazë të këtij ligji;

b) qiratë në pronat e paluajtshme të cilat ndodhen në komunë dhe të cilat janë nën administrimin ose në pronësi të komunës;

c) të hyrat nga shitja e pasurive komunale;

d) të hyrat nga ndërmarrjet të cilat janë plotësisht ose pjesërisht në pronësi të komunës;

e) bashkëpagesat nga konsumatorët e shërbimeve arsimore dhe shëndetësore të cilat ofrohen nga komuna;

f) të hyrat e realizuara nga cilado agjenci, departament ose organizatë e komunës si rezultat i ofrimit të çfarëdo malli ose shërbimi;

g) interesi në depozitat komunale, nëse ekziston;

h) grantet dhe/ose donacionet nga qeveritë e huaja (përveç ndihmës financiare nga Republika e Serbisë) ose nga organizatat e jashtme, duke përfshirë organizatat qeveritare dhe joqeveritare si dhe institucionet ndërkombëtare dhe multinacionale.

i) të gjitha kategoritë e tjera të të hyrave të cilat janë përcaktuar si të hyra vetanake komunale në bazë të një ligji të Republikës së Kosovës.

	Komuna: Vushtrri	THV - 2017	THV - 2018	THV - 2019
644		në Euro	në Euro	në Euro
<b>I-A.</b>	<b>TË ARDHURAT E ADMINISTRATËS KOMUNALE – Direkte</b>			
1	<b>Buxhet dhe Financa</b>	<b>762,500.00</b>	<b>883,235.00</b>	<b>883,235.00</b>
1.1.	Taksat e firmave	70,000.00	90,000.00	90,000.00
1.2.	Tatimi në Pronë	662,500.00	753,235.00	753,235.00
1.3.	Transakcionet	30,000.00	40,000.00	40,000.00
2	<b>Ispeksioni</b>	<b>26,000.00</b>	<b>26,000.00</b>	<b>26,000.00</b>
2.1	Pranime teknike	10,000.00	10,000.00	10,000.00
2.2	Pelqime sanitare	15,000.00	15,000.00	15,000.00
2.3	Gjobat e inspektionit	1,000.00	1,000.00	1,000.00
3	<b>Administrata</b>	<b>90,000.00</b>	<b>100,000.00</b>	<b>100,000.00</b>
3.1.	Sherbimet Administrative	90,000.00	100,000.00	100,000.00
4	<b>Urbanizmi</b>	<b>347,000.00</b>	<b>600,000.00</b>	<b>600,000.00</b>
4.1.	Lejet për ndërtim dhe konstruktive	267,000.00	500,000.00	500,000.00
4.2	Shfrytëzimi I pronës Publike	80,000.00	100,000.00	100,000.00
5	<b>Gjeodezi dhe Kataster</b>	<b>85,000.00</b>	<b>100,000.00</b>	<b>100,000.00</b>
5.1.	Hipoteka,RDDP,Dalje teren	60,000.00	70,000.00	70,000.00
5.2.	Listat poseduse,kopje plani,vertetime tjera.	25,000.00	30,000.00	30,000.00
6	<b>Ekonomi dhe Bujqesia</b>	<b>15,000.00</b>	<b>20,000.00</b>	<b>20,000.00</b>
6.1	Ndrrimi I tokes bujqesore në ndertimore	15,000.00	20,000.00	20,000.00
7	<b>Kultur Rini Sport</b>	<b>4,500.00</b>	<b>7,500.00</b>	<b>7,500.00</b>
7.1.	Palestra sportive	3,000.00	5,000.00	5,000.00
7.2.	Biblotekat	1,000.00	2,000.00	2,000.00
7.3.	Shtepia e Kultures	500.00	500.00	500.00
9	<b>Sherbimet Publike</b>	<b>95,000.00</b>	<b>130,000.00</b>	<b>130,000.00</b>
9.1.	Ndalja e veturave në rrugë	5,000.00	10,000.00	10,000.00
9.2	Taksat Rrugore	90,000.00	120,000.00	120,000.00
I-A.	Nëntotali I-A , Të ardhurat direkte (Tarifat dhe ngarkesat)	1,425,000.00	1,866,735.00	1,866,735.00
1.0.	Denimet në komunikacion,të grumbulluara përmes Nivelit Qendror (ShPK)	50,000.00	65,000.00	65,000.00
1.1.	Denimet e gjykatave	100,000.00	160,000.00	160,000.00
I - B.	Nëntotali I-B , Të ardhurat indirekte (Pjesa që i takon komunave)	150,000.00	225,000.00	225,000.00
I	<b>Totali I Administrates komunale (Direkte dhe Indirekte &amp; IA+IB )</b>	<b>1,575,000.00</b>	<b>2,091,735.00</b>	<b>2,091,735.00</b>
	<b>ARSIMI</b>			
1	Qerdhet	50,000.00	70,000.00	70,000.00
4	Mësimi joformalSHMP "Bahri Haxha"	20,000.00	25,000.00	25,000.00
5	Mësimi joformalSHMT "Lutfi Musiqi"	18,000.00	20,000.00	20,000.00
6	Të tjera	5,000.00	5,000.00	5,000.00
<b>II</b>	<b>Totali - Arsimi</b>	<b>93,000.00</b>	<b>120,000.00</b>	<b>120,000.00</b>
	<b>Të ARDHURAT NGA SHËNDETËSIA</b>			
1	Shëndetësia primare	60,000.00	100,000.00	100,000.00
2	Shërbimet Sociale	2,000.00	5,000.00	5,000.00
<b>III</b>	<b>TOTALI SHËNDETËSI</b>	<b>62,000.00</b>	<b>105,000.00</b>	<b>105,000.00</b>
Kodi 21	<b>TOTALI I TË ARDHURAVE VETANAKE TË KOMUNES ( I+II+III ):</b>	<b>1,730,000.00</b>	<b>2,316,735.00</b>	<b>2,316,735.00</b>
<b>IV.</b>	<b>Donatorët e mbrenshem ( IV )</b>			
1.1	Participimi I popullates	50,000.00	50,000.00	50,000.00

1.2	Grantet e donatorve te mbrendshëm (ministritë apo të tjerë)	15,000.00	15,000.00	15,000.00
<b>V</b>	<b>Donatorët e Jashtëm (V)</b>	200,000.00	200,000.00	200,000.00
	<b>Gjithsej të ardhurat e komunës ( I+II+III+IV)</b>	<b>1,995,000.00</b>	<b>2,581,735.00</b>	<b>2,581,735.00</b>

Ky planifikim i të hyrave vetanake të Komunës nuk është në përputhje me Qarkoren Buxhetore 2017/01 të lëshuar nga Ministria e Financave

### 3.2.1 Plani Komunal i Bashkëfinancimit Sektorial me Ministritë e Linjës dhe Donatorët

Vlera totale e projekteve me bashëfinancim të me Ministritë e Linjës dhe Donatorë gjatë viteve 2017-2019 është 2,203,000.00 Eur.


Tabela 3: Projektet për bashkëfinancim

Projekti	Partneri bashkfinancues	Komuna	Bashkëfinancuesi	Komente
Ndërtimi i rrugës magjistrale Nedakovc-Smrekovnicë-Vushtri	MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS	100,000.00	1,000,000.00	
Ndërtimi i ures mbi lumin Sitnica ne fshatin Pestove	MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS		270,000.00	
Ndërtimi i Palestres Sportive ne Samadrexhe te Vushtrise	MINISTRIA E KULTURËS		250,000.00	
Rehabilitimi i Shtëpisë së Mehmet Agë Gjinolli - Vushtri	MINISTRIA E KULTURËS	23,000.00	140,000.00	
Gypi i ujesjellesit Vushtri	MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK		300,000.00	Kerkesa është edhe për 299.900 euro në MZHE
Bashkëfinancim ne projekte per renovimin e rrjetit te Ujësjesit	LUX-DEV	50,000.00	50,000.00	
Bashkëfinancim ne projekte ne Bujqesi me IADK	IADK	20,000.00		

### 3.3 Shpenzimet komunale dhe Parashikimi i Tyre Afat-mesëm 2017-2019 (vitin e I-vitin e 3)

Sipas rekomandimeve të Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar të komunikuara përmes Qarkores Buxhetore komunale 2017/01 komunat do të kenë edhe në të ardhmen fleksibilitet në shpërndarjen e të hyrave vetanake komunale në Strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2017, duke përjashtuar kategorinë Paga dhe Mëditje. Si rezultat Komuna e Vushtrrisë prezanton këtë ndarje të shpenzimeve në mes të kategorive të lejuara buxhetore:

Figura 2: Shpenzimet komunale në kategori ekonomike, 2017-2019 (vitin e I-vitin e 3)



**3.3.1 Pagat dhe Mëditjet** – kategoria e shpenzimeve për paga dhe mëditje historikisht ka përfaqësuar pjesën më të madhe të shpenzimeve rrjedhëse dhe gjithashtu planifikohet që përgjatë periudhës planifikuese trendi i njëjtë të vazhdojë. Përgjatë periudhës planifikuese, kjo kategori pritet të ngritet gradualisht, e ndikuar kryesisht nga alokimi i mjeteve për implementimin e skemës së sigurimeve shëndetësore, si dhe implementimi i pjesës së kontratës kolektive që ndërlidhet me përvojën e punës. Si rezultat i ngritjes me të përsheptuar të BPV, shpenzimet për këtë kategori janë planifikuar të ulin pjesëmarrjen e tyre vjetore në BPV përgjatë periudhës afat-mesme. Rrjedhimisht, ngritja vjetore në këtë kategori të shpenzimeve në mesatare është planifikuar të jete në një masë prej rreth 4% përgjatë periudhës afat-mesme; për të shënuar një ngritje prej rreth 13% në fund të vitit 2019 në raport me nivelin e shpenzimeve të buxhetuara gjatë vitit 2016.

**3.3.2 Mallrat dhe Shërbimet** – me qëllim të racionalizimit të shpenzimeve Qeveritare për mallra dhe shërbime si dhe përfshirjes së iniciativave të reja të cilat në vetë bartin kosto shtesë për buxhetin, shpenzimet në këtë kategori janë planifikuar të mbajnë pjesëmarrjen e njëjtë në BPV me vitet paraprake, për të shënuar një rënie të vogël vetëm në vitin 2019. Si rrjedhojë, shpenzimet për këtë kategori pritet të shënojnë një ngritje mjaft të ulët vjetore, rreth 2% në mesatare përgjatë periudhës planifikuese.

**3.3.3 Subvencionet –** Në 2017 subvencionet që do të ofrohen janë për bujqësi, shëndetësi organizatat e ndryshme klubet sportive, kulturë,rini,sport , arsim(bursat) etj. Pjesëmarrja e subvencioneve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore gjatë viteve 2017-2019 mesatarisht do të jetë 1.5%.

**3.3.4 Investimet Kapitale -** kjo kategori e shpenzimeve do të shënojë ngritje të theksuar në krahasim me vitin 2016 ku kemi pasur nje rënje të investimeve. Trendi i ngritje s do të vazhdojë edhe në vitin 2018 për të shnuar nje ngritje më të madhe në vitin 2019 . Një pjesë e madhe e tyre planifikohet të financohet nga të hyrat vetanake të komunës. Pjesëmarrja e investimeve kapitale në totalin e shpenzimeve të komunës në vitin 2017 dhe tutje pritet të jetë mesatarisht: 25 – 30 %.

Tabela 6: Korniza Buxhetore Komunale, në euro

Komuna: Vushtrri	Grante dhe të hyra vetanake (HV) – 2016	Grante dhe të hyra vetanake – 2017	Grante dhe të hyra vetanake – 2018	Grante dhe të hyra vetanake – 2019
	në Euro	në Euro	në Euro	në Euro
<b>Burimet e të hyrave</b>				
Granti i përgjithshëm	5,075,275.00	5,482,302.00	5,682,184.13	5,964,153.38
Granti për arsim	6,291,206.00	6,372,875.00	6,372,875.23	6,372,875.23
Granti për shëndetësi	1,651,936.00	1,730,441.00	1,730,441.00	1,730,441.00
<b>Gjithsej Grantet</b>	<b>13,018,417.00</b>	<b>13,585,618.00</b>	<b>13,785,500.36</b>	<b>14,067,469.61</b>
<b>Të bartura</b>	459,100.00			
<b>Viti aktual</b>	1,703,418.00	2,316,735.00	2,316,735.00	2,346,060.76
<b>Gjithsej të hyrat vetanake</b>	<b>2,162,518.00</b>	<b>2,316,735.00</b>	<b>2,316,735.00</b>	<b>2,346,060.76</b>
<b>GJITHSEJ TË HYRAT KOMUNALE</b>	<b>15,180,935.00</b>	<b>15,902,353.00</b>	<b>16,102,235.36</b>	<b>16,413,530.37</b>

Tabelat në vijim janë një pasqyrë e shpërndarjes së shpenzimeve komunale në bazë të programeve apo katë funksionale si dhe në bazë të kategorive ekonomike. Shpenzimet në vijim janë ato aktualet të vitit 2016, plan për vitin e ardhshëm 2017 si dhe projeksionet e vitit 2018-2019.

Tabela 7: Shpenzimet Komunale 2016 (këtë vit), të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe

	2016 (këtë vit)					
	Prog Paga/Meditje ramet	Mallra/Sherbime	Shpenzime komunali	Subvencione	Shpenzime Kapitale	Gjithsej
Zyra e Kryetari	161,443.00	47,000.00		10,000.00		218,443.00
Zyra e Kuvendit komunal	123,020.00	10,000.00	-	-	-	133,020.00
Administrata dhe Personeli	161,300.00	130,000.00			5,000.00	296,300.00
Inspektimet	83,238.00	16,000.00	-	-	-	99,238.00
Prokurimi	27,201.00	6,000.00	-	-	-	33,201.00
Buxhet dhe financa	163,839.00	19,000.00	-	-	-	182,839.00
Infrastruktur Publike	65,794.00	204,571.00	105,000.00		975,000.00	1,350,365.00
Zjarrfiksit dhe Inspektimet	194,427.00	52,000.00	-	-	-	246,427.00
Menaxhimi I katastrofave	25,994.00	13,000.00	-	-	-	38,994.00
Zyra Komunale per Komunitet	45,084.00	5,000.00	3,000.00	-	-	53,084.00
Bujqësi,Pyltari dhe Zhvillim Rural	81,127.00	29,000.00	-	-	317,000.00	427,127.00
Kadastra dhe Gjeodezia	76,727.00	7,000.00	-	-	100,000.00	183,727.00
Planifikimi Urban dhe Mjedis	50,377.00	27,000.00	-	-	1,407,040.00	1,484,417.00
<b>Shëndetësi</b>	1,454,059.00	240,966.00	38,500.00	80,000.00	70,000.00	1,883,525.00
Administrata	30,500.00	2,500.00	-	50,000.00	-	83,000.00
Shërbimet e shëndetësis primare	1,354,470.00	212,466.00	35,000.00	30,000.00	70,000.00	1,701,936.00
Sherbimet Sociale	1,454,059.00	240,966.00	38,500.00	80,000.00	70,000.00	1,883,525.00
Kulturë, Rini dhe Sport	179,795.00	27,000.00	-	60,000.00	30,000.00	296,795.00
<b>Arsim dhe shkencë</b>	6,454,584.00	587,549.00	84,542.00	32,914.00	500,000.00	7,659,589.00
Administrata	70,200.00	453,720.00	-	32,914.00	374,879.00	931,713.00
Arsimi parashkollor	144,574.00	40,000.00	8,500.00	-	25,000.00	218,074.00
Arsimi fillor	4,815,004.00	72,033.00	57,042.00	-	100,121.00	5,044,200.00
Arsimi i mesem	1,424,806.00	21,796.00	19,000.00	-	-	1,465,602.00
<b>GJITHSEJ</b>	9,407,753.00	1,481,086.00	241,042.00	182,914.00	3,409,040.00	14,721,835.00

Tabela 8: Shpenzimet Komunale për vitin 2017 të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe

Përshkrimi	2017						
	Stafi 2016	Pagat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Total
Zyra e Kryetarit	21	167,900.00	47,940.00		10,000.00		225,840.00
Zyra e Kuvendit Komunal	0	127,940.00	10,200.00				138,140.00
Administrata dhe personeli	32	167,752.00	132,600.00			90,000.00	390,352.00
Inspektimet	14	86,567.00	16,320.00				102,887.00
Prokurimi	4	28,289.00	6,120.00				34,409.00
Buxheti dhe financat	29	170,392.00	19,380.00				189,772.00
Infrastruktura Publike	12	67,000.00	240,000.00	110,250.00		1,175,000.00	1,592,250.00
Zjarrfiksat dhe inspektimet	31	198,204.00	53,040.00				251,244.00
Menaxhimi i Katastrofave Natyrore	4	27,033.00	13,260.00				40,293.00
Zyra komunale për komunitete dhe kthim	10	46,887.00	5,100.00	3,150.00			55,137.00
Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi rural	15	84,372.00	29,580.00		390,000.00	80,000.00	583,952.00
Kadastra dhe gjeodezia	14	79,796.00	7,148.00			100,000.00	186,944.00
Planifikimi urban dhe mjedisi	8	52,392.00	27,540.00			1,676,406.00	1,756,338.00
Administrata	5	31,720.00	2,550.00		50,000.00		84,270.00
SH.K.P.SH	205	1,408,649.00	185,042.00	36,750.00	30,000.00	70,000.00	1,730,441.00
Shërbimet Sociale	13	71,852.00	26,520.00	3,675.00			102,047.00
Shërbimet rezidenciale	11	62,133.00	67,000.00	10,867.00		20,000.00	160,000.00
Kultura, rinia dhe sportet	36	186,986.00	27,540.00		70,000.00	65,732.00	350,258.00
Admimistrata	11	73,008.00	462,794.00		40,000.00	599,879.00	1,175,681.00
Arsimi Parashkollor dhe qerdhet	29	150,356.00	40,800.00	8,925.00			200,081.00
Arsimi Fillor	858	4,894,671.00	73,473.00	59,894.00			5,028,038.00
Arsimi I mesëm	222	1,481,798.00	22,231.00	19,950.00			1,523,979.00
<b>TOTALI</b>	<b>1584</b>	<b>9,665,697.00</b>	<b>1,529,178.00</b>	<b>255,461.00</b>	<b>590,000.00</b>	<b>3,862,017.00</b>	<b>15,902,353.00</b>



Tabela 9: Shpenzimet Komunale, projeksioni 2018 të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe

Përshkrimi	2018						
	Stafi 2016	Pagat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Total
Zyra e Kryetarit	21	171,258.00	48,898.00	-	15,000.00	-	235,156.00
Zyra e Kuvendit Komunal	0	130,498.00	10,404.00	-	-	-	140,902.00
Administrata dhe personeli	32	171,107.00	135,252.00			30,000.00	336,359.00
Inspektimet	14	88,298.00	16,646.00	-	-	-	104,944.00
Prokurimi	4	28,854.00	6,242.00	-	-	-	35,096.00
Buxheti dhe financat	29	173,799.00	250,000.00	-	-	-	193,566.00
Infrastruktura Publike	12	73,799.00	250,000.00	120,000.00	-	1,375,000.00	1,688,566.00
Zjarrfiksat dhe inspektimet	31	206,248.00	54,100.00	-	-	-	260,348.00
Menaxhimi i Katastrofave Natyrore	4	27,573.00	13,525.00	-	-	-	41,098.00
Zyra komunale për komunitete dhe kthim	10	47,824.00	5,202.00	4,000.00	-	-	57,026.00
Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi rural	15	86,059.00	30,171.00	-	420,000.00		536,230.00
Kadastra dhe gjeodezia	14	81,391.00	7,290.00	-	-	200,000.00	288,681.00
Planifikimi urban dhe mjedisi	8	53,439.00	28,090.00	-	-	1,682,253.00	1,763,782.00
Administrata	5	32,354.00	2,601.00	-	50,000.00	-	84,955.00
SH.K.P.SH	205	1,436,821.00	175,620.00	38,000.00	30,000.00	50,000.00	1,730,441.00
Shërbimet Sociale	13	73,289.00	27,050.00	3,675.00	-	-	104,014.00
Shërbimet rezidenciale	11	63,375.00	81,600.00	13,000.00		5,000.00	162,975.00
Kultura, rinia dhe sported	36	190,725.00	28,090.00	-	70,000.00	30,000.00	318,815.00
Admimistrata	11	74,468.00	472,049.00	-	40,000.00	374,879.00	961,396.00
Arsimi Parashkollor dhe qerdhet	29	153,363.00	41,616.00	9,100.00	-	25,000.00	229,079.00
Arsimi Fillor	858	5,107,756.00	74,942.00	62,000.00	-	200,000.00	5,444,698.00
Arsimi I mesëm	222	1,511,433.00	22,675.00	20,000.00	-	-	1,554,108.00
<b>TOTALI</b>	<b>1584</b>	<b>10,083,731.00</b>	<b>1,321,597.00</b>	<b>269,775.00</b>	<b>625,000.00</b>	<b>3,972,132.00</b>	<b>16,272,235.00</b>

Përshkrimi	2019						
	Stafi 2016	Pagat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Total
Zyra e Kryetarit	21	171,258.00	48,898.00	-	15,000.00	-	235,156.00
Zyra e Kuvendit Komunal	0	130,498.00	10,404.00	-	-	-	140,902.00
Administrata dhe personeli	32	171,107.00	140,000.00			20,000.00	331,107.00
Inspektimet	14	88,298.00	20,000.00	-	-	-	108,298.00
Prokurimi	4	28,854.00	8,000.00	-	-	-	36,854.00
Buxheti dhe financat	29	173,799.00	19,767.00	-	-	-	193,566.00
Infrastruktura Publike	12	73,799.00	230,000.00	120,000.00	-	1,375,000.00	1,798,799.00
Zjarrfiksat dhe inspektimet	31	206,248.00	60,000.00	-	-	-	266,248.00
Menaxhimi i Katastrofave Natyrore	4	27,573.00	20,000.00	-	-	-	47,573.00
Zyra komunale për komunitete dhe kthim	10	47,824.00	5,202.00	4,000.00	-	-	57,026.00
Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi rural	15	86,059.00	30,171.00	-	420,000.00		536,230.00
Kadastra dhe gjeodezia	14	81,391.00	7,290.00	-	-	200,000.00	288,681.00
Planifikimi urban dhe mjedisi	8	53,439.00	28,090.00	-	-	1,751,754.00	1,833,283.00
Administrata	5	32,354.00	2,601.00	-	50,000.00	-	84,955.00
SH.K.P.SH	205	1,436,821.00	175,620.00	38,000.00	30,000.00	50,000.00	1,730,441.00
Shërbimet Sociale	13	73,289.00	27,050.00	3,675.00	-	-	104,014.00
Shërbimet rezidenciale	11	63,375.00	81,600.00	13,000.00		5,000.00	162,975.00
Kultura, rinia dhe sportet	36	190,725.00	28,090.00	-	70,000.00	30,000.00	318,815.00
Admistrata	11	74,468.00	472,049.00	-	40,000.00	374,879.00	961,396.00
Arsimi Parashkollor dhe qerdhet	29	153,363.00	41,616.00	9,100.00	-	25,000.00	229,079.00
Arsimi Fillor	858	5,107,756.00	74,942.00	62,000.00	-	200,000.00	5,444,698.00
Arsimi I mesëm	222	1,511,433.00	22,675.00	20,000.00	-	-	1,554,108.00
	1584	10,083,731.00	1,554,065.00	269,775.00	625,000.00	4,031,633.00	16,564,204.00

Kategoria Ekonomike – Investimet Kapitale - e prezantuar në detaje më poshtë paraqet një komponentë të rëndësishme të buxhetit të komunës e cila ndonëse nuk përfaqëson pjesën më të madhe të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, mbetet me rëndësi të posaqme në aspektin e planifikimit, për Komunën e Vushtrrisë. Kjo kategori e shpenzimeve në kuadër të shpenzimeve të rregullta buxhetore, ka potencialin më të madh për të nxitur rritjen ekonomike. Andaj, kjo kategori e shpenzimeve, edhe gjatë periudhës së ardhshme afatmesme, do të vazhdojë të jetë në funksion të krijimit të ambientit më të favorshëm për ngritje të pjesëmarrjes së sektorit privat, përmes përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës. Përderisa ndikimi i këtyre investimeve në punësim dhe konsum është relativisht i shpejtë, ndikim i plotë i tyre në ekonomi do të mund të realizohet vetëm në periudhën afatmesme. Në këtë kontekst përmirësimi i infrastrukturës do të pozicionojë ekonominë e Komunës së Vushtrrisë në një rrugë të rritjes më të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike në periudhën afatgjatë.

Tabela 10: Projektet Kapitale të komunës 2017-2019, dhe kostoja e asociuar me total në Euro

<b>Projektet e propozuara</b>					
<b>Nr.</b>	<b>Drejtoria e Administrates</b>	<b>Shuma € 2017 (viti e 1)</b>	<b>Shuma € 2018 (viti e 2)</b>	<b>Shuma € 2019 (viti e 3)</b>	<b>Prioritet Strategjike</b>
	Inventar për objektin e ri të Komunës	80.000	10.000	10.000	<b>Administratë Funktionale</b>
	Teknologji informative	10.000	10,000	10,000	
	<b>TOTALI</b>	<b>90,000</b>	<b>20,000</b>	<b>20,000</b>	

<b>Drejtoria e shërbimeve publike</b>					
		<b>Shuma € 2017 (viti e 1)</b>	<b>Shuma € 2018 (viti e 2)</b>	<b>Shuma € 2019 (viti e 3)</b>	
	Sinjalizimi horizontal dhe vertikal	20,000	20,000	20,000	<b>Prioritet Strategjike</b>  Urbanizimi i Qendrës; Ndalimi i ndërtimeve të egra; Përmirësimi i infrastrukturës fizike; Mbrojtja e mjedisit; Identifikimi i burimeve të reja për financime të projekteve në infrastrukturë; Zvogëlimi i humbjeve të energjisë; Zhvillimi i projekteve për energji të ripërtërishme
	Rruget e rendit të katert	50,000	50,000	50,000	
	Furnizimi me gypa të ujërave të zeza	25,000	20,000	15,000	
	Ndërtimi i kanalizimeve	50,000	50,000	50,000	
	Projektet në bashkëfinancim me donator	200,000	200,000	200,000	
	Ndriçimi Publik	10,000	10,000	10,000	
	Rregullimi i lumit, "Terrstena"	42.913			
	Rregullimi i Varrezave të Dëshmorëve	34.600	30,000	20,000	
	Ndërtimi i trotuarit në Smrekonice	25.000			
	Ndërtimi i parqeve	45,000	45,000	45,000	
	Rekonstruimi i rrugëve të asfaltuara	40,000	40,000	40,000	
	Ndërtimi i rrugëve me kubza betoni	50,000	50,000	50,000	
	Ndërtimi i urave	20,000	20,000	20,000	
	Kamerat në qytet	5,000	5,000	5,000	
	Ndërtimi i trotuareve	50.000	50.000	50.000	

<b>TOTALI</b>	<b>667.513</b>	<b>690.000</b>	<b>575.000</b>	
---------------	----------------	----------------	----------------	--

<b>Bujqesi Pylltari dhe Zhvillim Rural</b>	<b>450,000</b>	<b>500,000</b>	<b>550,000</b>	
<b>Programi/projekti</b>	<b>Shuma € 2017 (viti e 1)</b>	<b>Shuma € 2018 (viti e 2)</b>	<b>Shuma € 2019 (viti e 3)</b>	<b>Prioritet Strategjike</b>
<b>Perkrahe bizneseve te reja dhe ekzistuese me paisje</b>	100.000	100.000	100.000	Përmirësimi i klimës së biznesit për një ambient më të favorshëm ndërmarrës; . Ruajtja e ambientit (mjedisit) gjatë aktiviteteve ekonomike; . Rritja dhe promovimi i investimeve përmes PPP, FDI dhe investimeve lokale; . Punësimi i personave pa shkollim universitar, riaftësimi i personave që janë të papunë për periudha të gjata për ruajtjen e identitetit ekonomik të komunës; Ndërlidhja më e mirë në mes institucioneve arsimore-hulumtuese dhe industrisë; Rritja e numrit të të vetëpunësuarve dhe atyre me aftësi për krijimin e vendeve të reja të punës; . Avancimi i agroindustrisë, zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë, pylltarisë e blegtorisë, promovimi si dhe subvencionimi i blegtorisë dhe pemëtarisë në zona kodrinore-malore; Lobimi për infrastrukturë të avancuar ligjore;
<b>Makina per sillazh te barit</b>	50.000			
<b>Perimkulture</b>	30.000			
<b>Makina per mjeljen e lopeve si dhe pako higjienike</b>	10.000			
<b>Pemetari(mjedra,qershi,lajthi,ftua)</b>	120.000			
<b>Makina per mbjellje te misrit</b>	40.000			
<b>Makina per mbjellje te grurit</b>	40.000			
<b>Rregullimi i lumenjeve dhe bademeve</b>	30.000			
<b>Fondi per bashkefinansim</b>	50.000			
<b>Projekte varesisht nga kerkesat e fermereve.</b>		400.000	450.000	
<b>TOTALI</b>	<b>470.000</b>	<b>500.000</b>	<b>550.000</b>	

<b>Kadastra dhe Gjeodezia</b>	<b>100,000</b>	<b>100,000</b>	<b>100,000</b>	
<b>Programi/projekti</b>	<b>Shuma € 2017 (viti e 1)</b>	<b>Shuma € 2018 (viti e 2)</b>	<b>Shuma € 2019 (viti e 3)</b>	<b>Prioritet Strategjike</b>
Shpronësimi i Tokave	200,000	200,000	200,000	

<b>Planifikimi Urban dhe Mjedisi</b>					
<b>Programi/projekti</b>	<b>Shuma € 2017 (viti e 1)</b>	<b>Shuma € 2018 (viti e 2)</b>	<b>Shuma € 2019 (viti e 3)</b>	<b>Prioritet Strategjike</b>	
Asfaltimi i rrugëve në Kunovik ( lagja Parparduzi - Muli )	105,470				
Asfaltimi i rrugëve në fshatin Bukosh,(lagja Osmani,Dushi,Mehmeti,Hajrizi	75,600				
Asfaltimi i rrugëve në Dumnicë lagja Abazi	22.336				
Asfaltimi i rrugëve në Dobërlukë ( Lagja Xhaferi - Merovci )	35.000				
Asfaltimi i rrugës në Ashlan ( Lagja Selatin Hyseni )	28.000				
Kontigjenca per korigjimin e TVSH-se	40.000				
Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatra	700.000	800.000	800.000		
Ndërtimi i rrugëve në Qytet	500.000	500.000	500.000		
Hartimi i projekteve	120.000	100.000	100.000		
Hartimi i planeve rregulluese	50.000	50.000	50.000		
<b>TOTALI</b>	<b>1,676,406</b>	<b>1.450.000</b>	<b>1.450.000</b>		

<b>Drejtoria e Shëndetësisë</b>					
<b>Programi/projekti</b>	<b>Shuma € 2017 (viti e 1)</b>	<b>Shuma € 2018 (viti e 2)</b>	<b>Shuma € 2019 (viti e 3)</b>	<b>Prioritet Strategjike</b>	
<b>1.Meremetimi QMF-së ne Lum te Madhë.</b>	12.000				
<b>2.Teknologji informative.</b>	15.000	15.000	15.000		
<b>3.Furnizim me inventar</b>	5.000	5.000	5.000		
<b>4.Vendosja e kulmit ne objektin QMF-së 1 Rr.D.Kombit</b>	32.000				
<b>5.Furniz. nji automjeti udhëtarve Kombi për pacient hemodializës.</b>	30.000				
<b>1.Ndërtimi i kulmit QMF-së ne Dervar</b>		12.000			
<b>3.Fur. i nji automjeti te udhëtarve për bartje te personelit shenetsor.</b>		18.000			
<b>4.Meremetimi dhe mirëmbajtja e QMF dhe AMF</b>	16.000	16.000	16.000		

	6.Ndertimi i objektit te ri te QKMF-së ne Qytet projekt tre vjeqar.		250.000	250.000	
	<b>TOTALI</b>	<b>110.000</b>	<b>316.000</b>	<b>286.000</b>	

	<b>Arsimi</b>	<b>Shuma € 2017 (viti e 1)</b>	<b>Shuma € 2018 (viti e 2)</b>	<b>Shuma € 2019 (viti e 3)</b>	<b>Prioritet Strategjike</b>
1	Ndërtimi i sh.f.në Maxhunaj,Druar, Pantinë	348,879.00			Ngritja e cilësisë në arsimin parauniversitar; Ngritja e kapaciteteve humane; Rritja e produktivitetit përmes përdorimit të teknologjisë; Rritja e investimeve në infrastrukturën arsimore; Përshtatja ndaj ndryshimeve të shpejta sipas nevojave dhe kërkesave të tregut
2	Ndërtimi i sh.f.në Dumnicë të mesme		374,879.00		
3	Inventar për shkolla	60,000.00	40,000.00		
4	Pajisje laboratorike	30,000.00	30,000.00	30,000.00	
5	Meremetimi i shkollave	85,000.00	35,000.00	149,879.00	
6	Rregullimi i fushave sportive	60,000.00		30,000.00	
7	Rrethoja		40,000.00	20,000.00	
8	Kompjuter	16,000.00	80,000.00	60,000.00	
9	Fotokopje			10,000.00	
10	Anekse për lëndë djegëse(shupa)			50,000.00	
11	Ndërtimi i sallës sportive në SHMP" B.Haxha"			250,000.00	
	<b>TOTALI</b>	<b>599,879.00</b>	<b>599,879.00</b>	<b>599,879.00</b>	
	<b>Gjithësejt : €</b>	<b>3,862,017</b>	<b>3,972,132.00</b>	<b>4,031,633.00</b>	

### 3.4 Analiza Gjimore

Buxhetimi i Përgjithshëm Gjinator tashmë është pjesë e kornizave legjislativë të vendit e cila kërkon nga të gjitha institucionet publike, të integrojnë barazinë gjimore në projektimin e politikave zhvillimore dhe në shpenzimin e parasë publike. Buxhetimi i përgjigjshëm gjinator pranon se gratë dhe burrat kanë marrëdhënie të ndryshme me ekonominë. Po ashtu, kjo ka të bëjë edhe me faktin se nëse duam të arrijmë progres të qenësishëm për barazinë gjimore, politikat pa buxhetet nuk mjaftojnë. Buxhetimi i përgjigjshëm gjinator kërkon që buxhetet t'u përgjigjen më mirë nevojave të njerëzve. Qëllimi është të integrohet aspekti gjinator si një kategori, analize dhe kontrolli në procesin buxhetor. Logjika mbi të cilën mbështetet buxhetimi i përgjigjshëm gjinator është se, si të gjitha politikat shtetërore, buxheti i prek ndryshëm gratë dhe burrat për shkak të nevojave dhe roleve të tyre mbi baza gjimore. Synimi i buxhetimit të përgjigjshëm gjimore është së sigurojë që masat e buxhetit të shtetit (si nga ana e shpenzimeve, ashtu edhe nga ana e të ardhurave të buxhetit) të marrin në konsideratë nevojat e ndryshme të grave dhe burrave dhe të vajzave dhe djemve; të sigurojë që buxheti kontribuon në zvogëlimin e pabarazisë gjimore; dhe të realizojë shërbime publike në mënyrë që të rritet barazia gjimore.

Komuna nuk ka përgatitur një buxhet të përgjigjshëm gjinator të detajuar, por është përpjekur për të vlerësuar se si shpenzimet kapitale janë ndarë për të adresuar çdo pabarazi gjimore në planifikimin e ardhshëm buxhetor. Ne kemi analizuar numrin e grave dhe burrave, djemve dhe vajzave në kuadër të komunës, dhe e kemi paraqitur këtë informacion në tabelat e mëposhtme:

Tabela 11:

Kategoria	Shifrat sipas Regjistrimit të Popullsisë 2011	%	Parashikimi për vitin 2016 (Varianti i mesëm)	%
Gra	17,541	25.11	18,583	25.54
Burra	15,891	22.74	16,366	22.49
Vajza	16,325	23.36	17,220	23.67
Djem	20,113	28.79	20,593	28.30
Popullata e përgjithshme	69,870	100	72,762	100

Viti	Numri total i stafit	Numri i stafit që janë gra	Numri i stafit që janë burra	Paga dhe mëditje (shuma për Gra)	Paga dhe mëditje (shuma për burra)
2013	1559	634	925	2,913,233.11	4,348,574.88
2014	1571	641	930	3,179,075.08	4,735,726.65
2015	1574	642	1004	3,340,064.34	4,829,183.66

Nivelet e pagave	Numri total i stafit në nivele të pagave	Numri i burrave	Shuma e shpenzuar për burra	Numri i Grave	Shuma e shpenzuar për Gra
201-400	260	213	788,880.00	47	278,560.00
401-600	1243	620	4,324,381.35	623	3,477,125.76
600+	42	40	214,115.00	19	29,802.33

## Informacionet sipas programeve

### Zyra e Kryetarit

**Misioni:** Misioni është që kjo zyrë të jetë e përgjegjshme dhe llogaridhënëse për të arritur rezultatet që avancojnë interesat e qytetarëve.

**Vizioni:** Ofrimi i këshillave për Kryetarin e komunës gjegjësisht ekzekutivin e komunës.

Duke ditur se posti i kryetarit të komunës përkatësisht qeverisë komunale kërkon angazhim dhe përgjegjësi të veçantë për të u ballafaquar me probleme të ndryshme si dhe duke pas parasysh gjendjen jo të mirë ekonomike dhe sociale në komunën tonë, vizioni ynë është që organet e komunës ti kryejnë obligimet e tyre dhe përgjegjësit në pajtim me ligjet, rregulloret, vendimet e kuvendit dhe aktet të tjera në fuqi, gjegjësisht për angazhim të shtuar dhe efektshmëri sa ma të madhe në punë si dhe për ofrim të shërbimeve sa ma cilësore të qytetarëve, për një jetë më të mirë, perspektiv dhe prosperitet në të ardhmen.

### Zyra e Kuvendit

**Misioni:** Për t'i shërbyer qytetarët e komunës, duke siguruar procedim me kohë për miratimin e duhur të propozimeve nga Kryetari i komunës respektivisht qeverisë komunale, në kuvendin e komunës, në përputhje me detyrimet ligjore.

**Vizioni:** Për të siguruar shqyrtimin në afat ligjorë dhe miratimin e politikave të komunës duke përfshi edhe legjislacionin brenda kompetencave ligjore të komunës siç janë: Statuti i komunës, rregulloret komunale, planifikimi buxhetor etj. e gjithë kjo në interes të qytetarëve të komunës së Vushtrrisë.

## Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës

**Misioni:** Një komunë e pastër dhe e sigurt për të gjithë qytetarët

**Vizioni:** Për të përmbushur obligimet statutores të Drejtorisë dhe adresimin e nevojave të qytetarëve tanë në fushën e rrjetit komunal rrugor, ujit dhe infrastrukturës së mbeturinave, hapësirave të gjelbra, shërbimeve emergjente dhe të sigurisë. Ne do të bëjmë këtë dhe arrijmë duke zbatuar mirëmbajtjen e planifikuar dhe përmirësimin e infrastrukturës së rrugëve, hapësirave publike (duke përfshirë parqet dhe varrezat), furnizimin me ujë dhe menaxhimin e ujërave të ndotura. Ne gjithashtu do të sigurojmë një plan të duhur që është në vend dhe zbatohet për mbrojtjen nga zjarri dhe emergjencat e tjera.

Indikatori	2017	2018	2019
% e rrugëve të asfaltuara	caku për vitin 2017	caku për vitin 2018	caku për vitin 2019
Km-të e trotuareve të ndërtuara			
% e ekonomive familjare me qasje në ujë të pijshëm			



% e ekonomive familjare të lidhura në sistemin e kanalizimit			
% e inspektimeve për siguri nga zjarri ku nuk janë gjetur shkelje			

## Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

**Misioni:** Një komunë ku popullata ka qasje më të përballeshme dhe efektive në shërbimin e kujdesit parësor shëndetësor dhe mbrojtjes dhe asistencës sociale.

**Vizioni:** Në Drejtorinë tonë ne punojmë për të zbatuar legjislacionin përkatës shëndetësor për të siguruar që shërbimet e mëposhtme primare shëndetësore për të gjithë qytetarët ofrohen në fushat e mjekësisë familjare, stomatologjisë, farmacisë, shërbimet laboratorike dhe kujdesin mjekësor emergjent. Ne i ofrojmë këto shërbime duke punësuar staf profesional dhe duke e trajnuar stafin mjekësor që vepron në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare . Përveç kësaj, ne gjithashtu do të punojmë për të siguruar nivelet e duhura të higjienës, që nga kryerja e inspektimeve sanitare për ujin e pijshëm, bizneset prodhuese, përpunimin ose shitjen e ushqimit, dhe atyre kompanive që merren me trajtimin e mbeturinave. Ne gjithashtu synojmë për të siguruar mbështetje të shërbimit social në pikat më të rrezikuara të bashkësisë sonë. Ne e bëjmë këtë përmes identifikimit të rasteve sociale, dhe këtë e bëjmë duke vlerësuar nevojën rast për rast.

<b>Indikatori</b>	<b>2016</b>	<b>2017</b>	<b>2018</b>
% e fëmijëve nën moshën 1 vjeçar që e përfundojnë rrethin e parë të imunizimit	95%	96%	98%
Rinovimi i objekteve shëndetësore; % e zbatimit të planit 3 vjeçar për përmirësimin e objekteve shëndetësore	100%	100%	100%
Raporti i numrit të doktorëve me numrin e qytetarëve	1 doktor ne 2500 banore	1 doktor ne 2300 banore	1 doktore ne 2000 banore
Numri fëmijëve shkollor që kryejnë kontrolle dentare përmes vizitave në shkolla vetëm gjatë kontrolleve sistematike të Kl para që kryhen çdo vit.	1070 nxënës	1100 nxënës	1200 nxënës
Numri e shkollave që marrin pjesë në fushatën për vetëdijësimin dentar vetëm gjatë kontrolleve sistematike të Kl para që kryhen çdo vit	1070 nxënës	1100 nxënës	1200 nxënës

## Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mjedisit

**Misioni:** Mjedis më tërheqëse natyror dhe përdorim më efektiv i tokës dhe ndërtesave në Kosovë

**Vizioni:** Planifikon zhvillimin hapësinor dhe urbanistik, përcjell dhe studion zhvillimin hapësinor brenda territorit të komunës (sipas metodologjisë bashkëkohore);

- Harton programe, planin zhvillimor të komunës, planin zhvillimor urban, dhe planet rregulluese urbane të vendbanimeve dhe tërësive tjera;
- Ofron sugjerime dhe mendime lidhur me procedurën për miratimin e tyre dhe propozon realizimin e tyre;
- Mbledh, përpunon dhe plotëson dokumentacionin e zhvillimit hapësinor, në harmoni me Ligjin për planifikimin hapësinor dhe dispozitat tjera të nxjerra në bazë të tij;
- Bashkëpunon me të gjitha subjektet pjesëmarrëse në planifikimin dhe zhvillimin e qytetit dhe të komunës për hartimin e planeve hapësinore;
- Merret me planifikimin urban dhe rural të komunës dhe të shfrytëzimit të tokës;
- Bashkëpunon rreth konceptit të zgjidhjeve dhe përmbajtjeve të planeve rregulluese urbane;
- Përcjell planifikimin urbanistik dhe projektimin dhe merret me zbatimin e tyre;
- Përgatit plane të detajuara urbanistike, projektet urbanistiko-arkitektonike për lagje dhe tërësi të caktuara të qytetit dhe komunës;
- Harton programe, detyra projektuese, me ndihmën e ekspertëve të përzgjedhur për organizimin e konkurseve urbanistiko-arkitektonike në nivel vendor dhe ndërkombëtar;
- Përgatit dhe ofron informacione bazë dhe dokumente për përgatitjen, miratimin apo ndryshimin e planeve hapësinore, urbanistike, rregulluese dhe planeve të detajuara të qytetit dhe të komunës;
- Propozon dhe zbaton rregullativën ligjore nga lëmi i planifikimit hapësinor: Planit zhvillimor të komunës, Planit zhvillimor urban, Planit rregullues urban, si dhe rregullativën nga lëmi i ndërtimeve investive;
- Përcakton kushtet urbanistike dhe arkitektonike për hartimin e dokumentacioneve investivo-teknike, për ndërtimin e objekteve lidhur me realizimin e projekteve kryesore urbanistike dhe zgjedhjet e tyre arkitektonike;
- Propozon dhe miraton kriteret për vendosjen e objekteve të përkohshme, pajisjeve dhe elementeve mikro-urbane në territorin e qytetit dhe komunës;
- Merret me hartimin e legjislacionit, ekspertizave analitike, veprimtarive të tjera në fushat e caktuara të planifikimit hapësinor dhe urban;
- Propozon dhe zbaton programin për hapësirën e komunës;
- Jep pëlqime për ndërtimin e objekteve të rëndësishme lokale dhe zhvillimeve të tjera;
- Organizon dhe kontrollon dokumentacionin teknik;
- Organizon dhe cakton grupin profesional për mbikëqyrje, pranime teknike të objekteve ndërtimore dhe shërbime tjera përkatëse;
- Lëshon vendime dhe vërtetime për gjendjen e objekteve ekzistuese;
- Konstaton dhe delegon informatat për objektet e ndërtuara në mospërputhje me ligjet ndërtimore, standardet dhe dokumentacionet urbanistike në fuqi;
- Jep leje për përdorimin e objekteve të përfunduara;
- Inicon programe për ndërtimin e infrastrukturës dhe objekteve kapitale në territorin e komunës;
- Bashkëpunon me subjektet përkatëse komunale në fushën e rregullimit të tokës ndërtimore;
- Propozon krijimin e zonave të tokës së ndërtimit dhe përpunon lokacionet për dhënie të tokës në shfrytëzim ;
- Zbaton programet e sektorëve të tjerë të Administratës komunale në fushën e ndërtimit të infrastrukturës dhe objekteve kapitale, si dhe vendimet komunale nga përgjegjësia e kësaj Drejtorie;
- Përgatit propozimet e rregulloreve dhe akteve tjera nga lëmi i ndërtimit, planifikimit, projektimit dhe rregullimit hapësinor;
- Udhëzon dhe orienton subjektet nga fusha e ndërtimit, bashkëpunon me subjektet udhëheqëse dhe personat juridikë nga fusha e ndërtimit, ofron të dhënat dhe informata të tjera bazike profesionale të nevojshme për punën e udhëheqjes komunale;
- Koordinon dhe kryen punët procedurale nga lëmi i ndërtimit;
- Kryen detyra të tjera të deleguara nga ligji dhe rregulloret tjera në fuqi;
- Harton projektprogramin për vlerësimin e gjendjes ekzistuese të tokës ndërtimore të komunës;
- Propozon dhe zbaton programin e veçantë për rregullimin e gjendjes ekzistuese të tokës ndërtimore të komunës;
- Organizon dhe trajnon grupet profesionale dhe kapacitetet njerëzore për procedurën e legalizimit. Organizon dhe cakton grupin profesional për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave (dokumentacioneve) për legalizim;

- Kontrollon dokumentacionin teknik në harmoni me ligjet ndërtimore, standardet, dokumentacionet urbanistike në fuqi, si dhe me rregulloren dhe Manualin për legalizim;
- Shqyrton programe për ndërtimin e infrastrukturës dhe objekteve kapitale në tërësitë hapësinore ilegale;
- Koordinon dhe kryen punët procedurale nga lëmi i ndërtimeve ilegale;
- Kryen edhe detyra të tjera në pajtim me dispozitat ligjore.

<b>Indikatori</b>	<b>2017</b>	<b>2018</b>	<b>2019</b>
Koha për lëshimin e lejes ndërtimore	30-40	30-40	30-40
% e lejeve të lëshuara brenda afatit ligjore	100	100	100

### **Bujqësi Pylltari dhe Zhvillimi Rural**

**Misioni:** Për të krijuar ambient tërheqës, bashkësi familjare ekonomikisht të qëndrueshme në zonat rurale duke përfshirë të gjitha grupet pa dallim etniteti, feje apo gjinie për një ambient të qëndrueshëm socio-ekonomik duke promovuar praktikën e mira bujqësore.

**Vizioni:** Qëllimi ynë kryesor është për të siguruar që numri maksimal i familjeve në zonat e fshatrave dhe sidomos fermat familjare do të zhvillohen dhe mbajnë një bazë ekonomike të qëndrueshme brenda komunës. Ne planifikojmë dhe ta bëjmë këtë duke mbrojtur tokën bujqësore përmes mbajtjes së një shënimi/të dhënave të sakta të përdorimit të tokës bujqësore dhe pronësisë së këtyre pronave. Ne do të bashkëpunojmë me bankat komerciale, për të shqyrtuar format e kreditimit për fermerët, dhe për të stimuluar dhe promovuar blerjet blektorale dhe zhvillimin bujqësor në këto mjedise. Ne gjithashtu bashkëpunojmë ngushtë me ekspert të IADK që të ofrojmë këshilla për fermerët për të zhvilluar kapacitet prodhues ngritjen e fuqisë së tyre konkurruese në treg duke promovuar praktikën me të mira bujqësore. Ne do të promovojmë mbrojtjen e mjedisit tonë natyror dhe të zbatojmë legjislacionin përkatës në fushën e mjedisit dhe ruajtjes së pyjeve.

<b>Indikatori</b>	<b>2017</b>	<b>2018</b>	<b>2019</b>
% e tokës bujqësore që është duke u kultivuar	caku për vitin 2017	caku për vitin 2018	caku për vitin 2019
5986 ha	6083 ha	6154 ha	6250 ha

### **Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës**

**Misioni:** Çdo personi do duhet t'i mundësohet arsimit sporti dhe kultura nëpërmjet përvojave të të nxënies pozitiv, dhe do të stimulohet për arritjet e tij / saj të plota, veprime të cilat do ju japin atyre besim dhe do të gjejnë vet përmbushje me atë që merren.

**Vizioni:** Qëllimi ynë është që të sigurojmë qasje të barabartë për të gjithë fëmijët brenda komunës, në sistemin e arsimit cilësor, parashkollor, fillor dhe atë të mesëm. Ne gjithashtu do të mbështesim sigurimin e edukimit të mëtejshëm për të rriturit. Për ta bërë këtë ne kemi siguruar zbatimin e rregullores kombëtare dhe legjislacionit e duhur arsimor, dhe politikën gjegjëse si

rezultat. Ne marrim pjesë në përzgjedhjen e stafit dhe drejtorëve të shkollave për të siguruar se profesionistët dhe të kualifikuarit janë të punësuar për të mësuar qytetarët tanë, të rinjtë dhe të moshuarit. Ne i mbajmë të gjitha shënimet e nevojshme komunale të arsimit dhe statistikat për të matur nivelin e cilësisë së arsimit që ofrohet nga komuna. Ne komunikojmë hapur me publikun për të gjitha çështjet që lidhen me politikën e arsimit dhe të procesit përbrenda komunës. Ne gjithashtu bëjmë promovimin e sportit dhe kulturës me organizimin e ngjarjeve sportive dhe kulturore, përkrahjen e organizatave sportive dhe drejtimin e qendrës komunale të kulturës.

<b>Indikatori</b>	<b>2017</b>	<b>2018</b>	<b>2019</b>
% e fëmijëve që arrijnë moshën për të filluar shkollën	8 %	7.93 %	7.91%
% i nxënësve që kalojnë provimin shtetëror	53.95 %	54.33%	55.05%
% e shkollave që kanë kaluar nga sistemi me 3 ndërrime në sistemin me 2 ndërrime	100 %	100 %	100 %
Raporti i numrit të mësuesve me numrin e fëmijëve parashkollorë, fillorë dhe të mesëm.	Niveli o, 1:17.4 Niv. 1 dhe 2 1:16% Niveli 3, 1:17	Niveli o, 1:17.4 Niv. 1 dhe 2 1:16% Niveli 3, 1:17	Niveli o, 1:17.4 Niv. 1 dhe 2 1:16% Niveli 3, 1:17

## **Drejtoria e Administratës dhe Personelit**

**Misioni:** Për të qenë më të mirë në ofrimin e shërbimeve administrative - të kuptuarit se ofrimi i veprimeve dhe shërbimeve tona dhe suksesi ynë është i lidhur me kënaqësinë e qytetarëve.

**Vizioni:** Ne kemi për qëllim të ofrojmë shërbime cilësore për qytetarët tanë në një kohë dhe në mënyrë efikase nëpërmjet Qendrës së Shërbimit të Qytetarëve. Llojet e shërbimeve që ne ofrojmë janë regjistrimet e qytetarëve dhe lëshimi i certifikatave. Ne gjithashtu sigurojmë mbështetje administrative dhe këshilla për të gjitha drejtoritë tjera komunale dhe Kuvendin për të ju mundësuar atyre që t'i arrijnë objektivat dhe synimet e tyre. Lloji i mbështetjes logjistike që ne ofrojmë përfshin ruajtjen, transportin, postën, inventarizimin, sigurinë, përkthimin e dokumenteve zyrtare, mirëmbajtjen e pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe mirëmbajtjen e ndërtesave. Për të përmirësuar transparencën për qytetarët tanë, ne mirëmbajmë dhe e freskojmë rregullisht faqen e internetit të komunës

<b>Indikatori</b>	<b>2017</b>	<b>2018</b>	<b>2019</b>
Lëshimi i dokumenteve të gjendjes civile	60,000	60,000	60,000
Numri i kërkesave të pranuar nga QSHQ	70,000	70,000	70,000

## **Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Buxhetit**

Misioni: Arritja e niveleve më të larta të ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit në menaxhimin e burimeve komunale

Vizioni: Nëpërmjet planifikimit të duhur dhe menaxhimit të resurseve komunale, ne përpiqemi që të promovojmë vlerën për ofrimin e të gjitha shërbimeve për qytetarët e Vushtrrisë. Ne mbikëqyrim planifikimin dhe zbatimin e buxhetit komunal për të siguruar pajtueshmërinë me të gjithë legjislacionin e financave, statutit dhe rregulloreve tjera përkatëse. Ky veprim përfshin zbatimin e rregullores mbi tarifën dhe pagesat, veprime që lidhen me mbledhjen e tatimit në pronë. Ne gjithashtu do i përgatisim të gjitha raportet financiare dhe llogaritë vjetore në përputhje me kërkesat statutores komunale.